



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 36

Tiranë – E hënë, 25 mars 2019

## PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 11146, datë 18.3.2019	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 1589
Dekret i Presidentit nr. 11147, datë 19.3.2019	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 1589
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 145, datë 20.3.2019	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 953, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 92/2014, ‘Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë’”, të ndryshuar..... 1589
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 154, datë 27.2.2019	Për disa ndryshime në vendimin nr. 633, datë 26.10.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për masat kundër ndotjes së ajrit nga shkarkimet e mjeteve motorike dhe reduktimin e shkarkimeve në ajër të ndotësve të gaztë dhe të lëndës së ngurtë pezull nga motorët me ndezje pozitive dhe ata me ndezje me kompresion që djegin gaz natyror apo të lëngshëm për përdorim në automjete”..... 1591
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 20, datë 13.3.2019	Për dhënien e miratimit paraprak për zotërimin nga OTP Bank Nyrt, Hungari, të 88.89 për qind të kapitalit aksionar të Bankës Societe General Albania sh.a..... 1592
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 21, datë 13.3.2019	Për dhënien e miratimit paraprak për zotërimin nga Banka Union sh.a. të 100 për qind të kapitalit aksionar të Bankës Ndërkombëtare Tregtare sh.a..... 1592
Vendim i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 86, datë 20.3.2019	Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të listës shumëmemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, qarku Tiranë, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë..... 1593
Vendim i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 87, datë 20.3.2019	Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të listës shumëmemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, qarku Fier, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë..... 1595



20. Lidhëse dhe ambalazhim të barit të thatë ose të njomë (kodet sipas NKM-së 84333000).

21. Shkulëse të rrënjëve ose zhardhokëve, panxharit etj., me motor dhe pa motor të tërhequra nga traktori ose jo (kodet sipas NKM-së 84335310, 84335330).

22. Korrësit e foragjereve dhe silazhuesit me motor dhe pa motor, të vetëdrejtuar ose të tërhequra nga traktori (kodet sipas NKM-së 84335911, 84335919).

23. Mjelësit e qumështit, sistemet e përgatitjes dhe shpërndarjes së ushqimit të bagëtive dhe shpendëve (kodet sipas NKM-së 84341000).

24. Makinë korrje shirje e kombinuar; makineri për përgatitjen e ushqimeve të kafshëve (kodet sipas NKM-së 84335100; 84361000).

25. Makinat për seleksionimin dhe klasifikimin e farave, drithërave apo fruta-zarzarvateve (kodet sipas NKM-së 84371000).

26. Motokultivatorët e ndryshëm me një aks (kodet sipas NKM-së 87011000).

27. Traktorë bujqësorë me goma dhe me zinxhirë (kodet sipas NKM-së 87019110, 87019210, 87019310, 87019410, 87019510, 87013000).

28. Tharësit për produktet bujqësore (kodet sipas NKM-së 8419 31 00).

*Shënim: Përfshirja nga TVSH-ja është për makinat bujqësore, të cilat kanë përshkrimin sipas kësaj liste dhe kodin tarifor përkatës.*

## VENDIM

Nr. 154, datë 27.2.2019

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 633, DATË 26.10.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MASAT KUNDËR NDOTJES SË AJRIT NGA SHKARKIMET E MJETEVE MOTORIKE DHE REDUKTIMIN E SHKARKIMEVE NË AJËR TË NDOTËSVE TË GAZTË DHE TË LËNDËS SË NGURTË PEZULL NGA MOTORËT ME NDEZJE POZITIVE DHE ATA ME NDEZJE ME KOMPRESION QË DJEGIN GAZ NATYROR APO TË LËNGSHËM PËR PËRDORIM NË AUTOMJETE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikave 1 e 3, të nenit 13, të ligjit nr. 162/2014, “Për

mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis”, të nenit 79, të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë dhe të ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

## VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 633, datë 26.10.2018, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Shkronja “c”, e pikës 8, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“c) Autoveturat e përdorura, të gjitha ato që nuk janë me zero km dhe që janë regjistruar më parë për qarkullim në rrugë në një shtet tjetër, të cilat përmbushin normën Euro 4.”.

b) Pika 9 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Automjetet e blera para hyrjes në fuqi të këtij vendimi, që janë nisur për t’u çliruar për qarkullim të lirë dhe regjistruar në Republikën e Shqipërisë dhe që kanë hyrë në territorin shqiptar brenda datës 31.12.2018 dhe nuk kanë përfunduar procedurat doganore dhe të regjistrimit, kanë afat deri në 31 dhjetor 2019, për kryerjen e procedurave të nevojshme.”.

c) Pika 11 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“11. Ngarkohen autoritetet doganore të kontrollojnë dokumentacionin shoqëruar të mjetit motorik dhe të ndalojnë importin e mjeteve motorike që nuk plotësojnë kushtet e përcaktuara në pikat 4 dhe 8, të këtij vendimi.”.

2. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, autoritetet doganore, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Edi Rama**